



Tirana dhe Laçi janë ndare në barazim. Ndeshja e luajtur në Qemal Stafa ka ngjallur një interesim jo të vogël nga dy tifozëritë por pavarësisht atmosferës, të dyja skuadrat nuk kanë shkuar dot tek goli. Bardhelutë kanë patur disa raste në pjesën e parë por Cota ka gabuar në finalizim. Për Tiranën ka luajtur disa nga futbollistët e afruar në ditët e fundit të merkatos duke i rritur forcën e skuadres por kjo nuk ka mjaftuar për të marrë tre pikët. Laçi është paraqitur serish me një skuadër solide në fushë, e pathyeshme në mbrojtje dhe e vendosur mjaft mirë në mesfushë. Përgjatë 90 minutave të dyja ekipet kanë provuar ta thyejnë njëra tjetrën por nuk ja kanë dalë të gjejnë golin. Në përfundim kanë ndarë mes tyre nga një pikë që vlen me tepër për kurbinasit që e moren në transfertë se për Tiranën që luajti në shtëpi.